



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL NGA SEANCA E III E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Seancën e ftoi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, z. Naim Pira.

Seanca është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 29.03.2016 (e Martë), duke filluar nga ora 10.<sup>00</sup>. Në seancë prezantuan 26 anëtarë të Kuvendit, mungoi një këshilltarë me arsye. Në seancë ishin prezent edhe nënkryetari i Komunës z.Hasan Alia me drejtorët e Drejtorive, përgjegjësja i Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i OSBE-së, OJQ-të dhe mediat e shkruara dhe elektronike.

Kryesuesi para se të filloj me punë sipas rendit të ditës i përshëndeti të gjithë të pranishmit, nënkryetarin e Komunës, këshilltarët e Kuvendit, drejtorët e Drejtorive, përfaqësuesin e OSBE-së, OJQ-të.

**Kryesuesi:** Kam kënaqësinë e veçantë që sot të përshëndes profesorin e nderuar z.Mevlan Bixhaku, i cili është konsulent i DEMOS-it, gjithashtu edhe znj.Ermira Salihu, përfaqësuese e DEMOS-it, e cila sot është në këtë seancë të rregullt të Kuvendit.

Pas numërimit nga sekretaria të këshilltarëve në sallë, kryesuesi konstatoi se kemi kuorum dhe mundemi me filluar me punë të seancës së III të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë.

**Kryesuesi:** Para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës, ju e dini se kemi pasur gjithmonë të ndryshme, por me pëlqimin e juaj, me që sot e kemi prezent profesorin e nderuar dhe përfaqësuesin e DEMOS-it për shtjellimin e një pike të rendit të ditës të cilën e kemi, kisha dashtë nga ju që pyetjet dhe propozimet ti lëmë në fund të seancës. Desha me marrë konfirmimin nga ana e juaj: Kush është që kjo të mbetet pas pikave të rendit të ditës?, me ngritje dore nëse banë. Konstatoj se me shumicën e votave kjo mbeti pas përfundimit të pikave të rendit të ditës.

Për seancën e tretë të Kuvendit kemi paraparë këtë:

### Rend dite

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KK-së.
2. Draft plani i mobilitetit të qëndrueshëm për Komunën e Vitisë.
3. Propozim vendim për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën ekonomike me statusin “Parku Industrial” në fshatin Budrigë e Epërme.
4. Propozim rregullore për qendrën rinore-Viti.

5. Propozim rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.
6. Propozim vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2015 në vitin 2016

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm?, nëse nuk ka e hedhim në votim për miratim rendin e ditës. Konstatohet se me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë kemi:

**1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KK-së.**

Hapim debat rreth pikës së parë: A donë ta merr fjalën dikush?, pasi nuk ka e hedhim në votim për miratim. Konstatohet se me vota unanime miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë kemi:

**2. Draft plani i mobilitetit të qëndrueshëm për komunën e Vitisë.**

**z.Bushat Zuka:** Pasi javën e kaluar e kishim mbledhjen e KPF-së, kur e prezantuar Draft plani i mobilitetit të qëndrueshëm për Komunën e Vitisë, patëm disa vërejtje dhe disa kritika, që sipas shumicës tonë ishin vërejtje kritike edhe me aktivitetin tonë besoj se shumicën e tyre i kemi mënjanuar, por për shkaqe teknike nuk kemi mund me i sjell me përmirësime. Ma shumë unë nuk dua me zgjat, pasi kemi profesorin këtu dhe do të prezantohet këtë Draft nëpërmjet sllajdave.

**z.Mevlan Bixhaku.** Fillimisht ju përsëritet të gjithëve asamblistëve të Komunës së Vitisë, është kërkuar nga ne që edhe një, ndoshta për nevojat të sqarimeve shtesë, lidhje me përmbajtjen e planit të mobilitetit po i japim disa sqarime të cilat ndërlidhen me masat, respektivisht me objektivat të cilat kanë qenë ndoshta edhe pikësynim për hartimin e mobilitetit. Një herë më lejoni që si shkurt pak, se edhe meqenëse edhe me grupin punues jemi munduar për secilin kapitull të hartuar të japim edhe sqarime gjatë punës që kemi bërë bashkë me grupin punues, mirëpo çështjen e mobilitetit, meqenëse është në interes edhe të asamblistëve që janë prezent, meqenëse plani i mobilitetit në parim është një plan strategjik, i cili e trajton kryesisht problemin e trafikut ma tepër dhe ajo që është ma interesant deri tash në shumicën e planifikimeve që janë bërë ka qenë qëllimi që të akomodojmë automjetet, respektivisht që me automjete ta rregullojmë qarkullimin, dhe ky plan i mobilitetit ndoshta ka për qëllimin me ja u kthye qytetin qytetarëve, me ul shkallen e motorizimit edhe si rrjedhojë me ju dhanë mundësi që të gjitha strukturat jo vetëm se automjetet, mirëpo në radhë të parë me ju dhanë mundësi këmbësorëve, çiklistëve dhe natyrisht edhe një kategori që është shumë e rëndësishme, me qenë pjesë e integritimit ditore, personave ne nevojat të veçanta, te pas parasysh ndoshta këtë qëllim të mobilitetit ne jemi fokusuar për Komunën e Vitisë që mi trajtua në radhë të parë këto probleme. Unë tash nëpërmjet sllajdeve do ta bëjë prezantimin e tërësishëm të këtij plani.

**Kryesuesi:** E falënderojmë profesorin e nderuar për shpjegimin e këtij plani të mobilitetit që bëri dhe hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

**z.Samet Idrizi:** Unë e falënderoj profesorin për ekspoziteun që i bëri draftit për mobilitetin në Komunën e Vitisë, desha me thanë na me kohë grupi i PDK-së i kemi bërë vërejtjet tona ma herët, nuk kam qenë shumë i qasur në këtë punë, kam disa vërejtje të vogla, por normal edhe një propozim sa i përket prerjes së rrugës, ku dhe del mes postës aty, kjo nuk po më pëlqen hiq, se vërtetë është një degresion që i bëhet pamjes si fushë prej PRO KREDIT-it deri në fund, ajo është mirë mos me u lejua në asnjë mënyrë edhe po ashtu i bënë pengesë këmbësorëve që vinë prej poshtit në krahun e djathtë. Kjo është mirë mos me u lejua në asnjë mënyrë, por duhet me u ruajt tërësia e rrugës. Tjetër, parkingjet e njëtrajtshme apo drejtvizore që po parashihen me u bë, ato janë shumë të vështira, janë të vështira edhe për me u parkua pastaj edhe bëjnë pengim në komunikacion, këtë po e flas prej praktikave. Tjetër, unë e di që nuk lejojnë kushtet, mirëpo nëse flasim për një shëtitore brenda Komunës së Vitisë, në qytet, është mirë megjithëse është shumë vështirë me u ruajt, p.sh.: prej te pasqyra me u bë barriera e deri te PRO KREDIT BANKA, kjo pjesë se kështu e kemi edhe në Ferizaj, Prishtinë e shumë vende të tjera, se shëtitortja duhet me qenë e drejtë se ka edhe pamjen e efektit vizual ma të mirë, por edhe lëvizjen.

**z.Sejdi Emiri:** Shumicën e vërejtjeve i kemi dhënë ma herët edhe na këtu në kuvend si asamblistë, tu i përmend, p.sh.: atje TAX-it, rrugët dytësore, mirëpo atje te pasqyra ku TAX-it po heken është mirë shumë, mirëpo unë mendoj se ka me qenë i njëjti problem me stacionin e autobusëve, sepse nuk ka hapësirë aty që mu ndal autobusi, ndoshta nuk ka tjetër zgjidhje, mirëpo prapë ka me qenë pengesë në të ardhmen. Mirëpo pyetjen konkrete që e kam është kjo: Sa është kosto e përgjithshme e këtij implementimi për 5 vitet e ardhshme?

**z.Bekim Azizi:** E përmendi Bushati që janë bë do përmirësime, do vërejtje që u patën dhënë në KPF, përderisa neve nuk na vinë na nuk i shohim ato përmirësime. Qeky plan i veprimit që i paraqiti edhe disa pika profesori, është plan që nuk do të realizohet, është plan i dështimit, nuk është plan bindës kjo që është bërë, e para sepse në vitin 2016 parashihen diku 50 mijë euro të investohen në këtë planë, ndërsa na në buxhet nuk i kemi nda ato pare dhe nuk ka mundësi asnjë cent të hynë në vitin 2016, që në start qa është paraparë për këtë vit kjo dështon. Lëvizja në komunikacion numër një është siguria në komunikacion, edhe eko-ngasja ose ruajtja e ambientit që parashihet, mirëpo dy verizone që na dhanë në rrugën “Adem Jashari” te dyja janë jofunksionale, njëra kthehet përmes postës del në rrugën “Kongresi i Manastirit”, që nuk është e përshtatshme, e dyta kthehet me kthim gjysmë rrethor, 180 shkallë dhe kthehet nga ka ardhur, d.m.th asnjëra nuk është funksionale, asnjëra nuk është e pranueshme. Qendra te sheshi “Njazi Azemi”, lëvizje e pamotorizuar: A ka lëvizje aty apo vetëm parkingjet dislokohen? Tash nëse nuk ka lëvizje aty: Çka do të bëhet me rrugën “28 Nëntori”? Nga komuna që del te rruga e “UQK-së”, që lidhen se edhe ajo nuk ka mundësi të funksionoj, nëse ajo bllokohet, tash plani nuk është i bërë mirë. Plani paraqet për Komunën e Vitisë parashihet vetëm rruga “Adem Jashari”, plani mobil i Vitisë, fatmirësisht Vitia e ka disa rrugë që lidhen drejtë, i ka dy rrugë përmes lumit, te dyjat duhet të jenë detajisht në planin e mobilitetit, lëvizja ma atraktive e gjitha qyteteve të botës bëhet përkaj lumi, aty duhet të bëhet pjesa atraktive e lëvizjes, d.m.th nuk janë të parapara të gjitha rrugët. Plani i mobilitetit nëse nuk i paraqet të gjitha fshatrat, unë mendoj çdo rrugë, çdo udhëkryq, çdo vend që paraqitet në qytet duhet të shikohet, për atë këtu në Viti u paraqit vetëm rruga “Adem Jashari”, parkingjet të dislokohen poshtë atje, përfundi Kishës edhe nuk ka diçka tjetër që nuk është bindës për mua. Vendet e sigurisë, udhëkryqet që i paraqet këtu bisedohet vetëm te udhëkryqi i Pozheranit, udhëkryqet që janë problem te siguria janë si ti hysh rrugës magjistrale te udha e Smirës, te rruga e Verbanit, te dyja duhet të përfshihen këtu detajisht, pra, gjitha udhëkryqet duhet të përfshihen detaisht, jo vetëm ky i Pozheranit, sepse ato janë

udhëkryqe në rrugë magjistrale, që janë për siguri, ato nuk janë paraqit fare, këtu ka shumë sende që nuk janë përmend këtu, pjesa e shkollës së mesme, ura që ka mbet pa u ndërtuar e shumë të tjera. Unë nuk jam kundër një plani, por mënyrën si është bërë ky plan unë do ta abstenoj.

**z.Daut Xhemajli:** Unë pak a shumë atë që e kam thanë edhe në KPF, dua me thanë edhe këtu, dhe do të shtoj edhe diçka tjetër, por në fillim absolut nuk jam i kënaqur me këtë plan që është ofruar, unë mendoj që ne si këshilltar edhe duhet ti bëjmë propozimet tona konkrete, të kthehet ky plan dhe të shqyrtohet seriozisht në mënyrë që pas atyre vërejtjeve të pranueshme e kam fjalën të kthehet prapë në kuvend edhe të diskutohet për një plan i cili besoj që për disa vjet do të ishte perspektivë e jona edhe do të ishte plan i qëndrueshëm, pse po e them këtë, te pas parasysh se pak i përmendi edhe Bekimi ato që i kemi thanë në KPF, unë mendoj që këtu kemi të bëjmë me dy çështje edhe disa veprime në rrugë regjionale, që ndoshta nuk na takojnë neve që do ti kemi plane konkrete që ti propozojmë, ose të bashkëpunojmë me Ministrinë e Infrastrukturës, në mënyrë që ti realizojmë ato sikur që është rruga e Pozheranit ose rruga Ferizaj-Gjilan dhe rruga jonë prej Gerlice e deri në Letmicë. Unë mendoj që në ndërhyrje në këto rrugë si me nënkalime është dashtë të trajtohet sidomos te shkolla e Drobeshit, duhet të kryhen në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, nuk e kemi problem vetëm Drobeshin, kemi problem edhe Germoven, Ramjanin, Radivojcin e shumë të tjera, që mendoj se na duhet ti kemi vijat e qarta edhe gradualisht, d.m.th ti realizojmë ato kyçje ma të leta ose pengesa që janë në këtë, kam përshtypjen sikur ky grupi është ndal ma shumë në qendrën e Vitisë, por edhe këtu kam vërejtjet e mia nuk i kam për profesorin, por i kam për grupin lokal që u dashtë për ditë me dal me i pa e me i shkel në mënyrë që seriozisht me pa zgjidhjen që kishin me afrua, sipas meje propozimi im është që parkingjet si janë propozua në rrugën “Adem Jashari”, unë mendoj se në qendrën e Vitisë duhet të eliminohen tërësisht, pra nuk duhet të ketë kësi lloj parkingje, se rruga nuk duhet ta ketë destinimin vetëm për parking, d.m.th, në këto rrugët e tona që janë në qendër edhe për anash si është rruga nga Morava dhe nga “Kongresi Manastirit” duhet të mendohet për parkingje gjatësore, por qendra e Vitisë qysh është mendua me u lirua prej krejt automjeteve prej shtëpisë së kulturës e deri atje lartë, unë mendoj që nuk duhet pse, se Vitia apo kjo qendër shumë kohë duhet që të ngarkohet me njerëz të ketë lëvizje të njerëzve, përveç muajve gushtë kur vinë bashkatdhetarët, përndryshe këtë qendër kurrë nuk mund me pas me njerëz. Kjo rrugë duhet të jetë dy kahe, por me parking gjatësor dhe taksistët e kësaj pjese përball komune sipas meje duhet të zhvendosen në këtë pjesën këtu prej kësaj rrugës, ku kthehet për te shtëpia kulturës e deri te Lindi në mënyrë që ata të kenë mundësi me mundësi të lëvizjes. Rruga “28 Nëntori” duhet është propozim i imi duhet të bllokohet tërësisht, vetëm duhet të lihet një hapësirë nga banka nga Pro Kredit banka, që automjetet zyrtaret mund të afrohen e kam fjalën automjetet zyrtare të nivelit qendror, sepse gjitha shërbimet ka mundësi të sillen dhe të kryhen prej anës së poshtme rruga “Kongresi i Manastirit” njërën anë. Unë mendoj se ka mundësi të shfrytëzohet për parking, sipas meje fundi i kësaj rruge duhet të shfrytëzohet prej taksistëve, por pak është problem çështja e stacionit të autobusëve në atë pjesë ku përball ati objekti ku janë taksistët ekziston mundësia, po është shumë hapësirë e ngushtë për ndalje, por pasi ndaljet e autobusëve nuk janë aq të shpeshta ka mundësi mu bë ajo punë, por ana tjetër mua më duket propozim shumë i gabuar ose duhet ma naltë me u kanë se ne balla të rrugës ku vendosen taksistët ku janë propozua edhe në anën tjetër me u ndal autobusët dhe me u pengua komunikacioni bash në atë drejtim, për mua teknikisht nuk po ma merr mendja, nuk janë trajtuar, e përmendi edhe Bekimi, dy problemet ndoshta kryesore apo njëjtë të këtyre taksistëve te shkolla mesme nuk është menduar fare për një zgjidhje për me eliminua një

pengesë në skaj të rrugës dhe në vendin ku ndalen bash autobusët dhe nuk është trajtua ajo pjesë dhe u dashtë me u trajtuar, unë e di se ka mundësi me u rregulla aty me një numri mbajtës dhe zgjerohet rruga për një 4 metra, apo ma shumë, por problemi është të trajtohet ajo pjesë, e kam fjalën prej kësaj ure deri te ura e shenjtë që nuk e kemi përmendur fare aty, ndalen autobusët, aty ndalen taksitë, aty rrinë qytetarët, ndoshta është vendi ma kritik në Komunën e Vitisë, u dashtë me u trajtua edhe ky vend. Unë mendoj se qendra Vitisë qysh është propozua nuk është zgjidhje.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Unë e lejova debatin pak ma gjatë, për faktin që është një draft i rëndësishëm për komunën tonë. Me që na u bashkëngjit edhe kryetari, më lejoni që ta përshtëndes.

**z.Bislim Bislimaj:** Këto nuk kanë qenë pyetje, këto ma shumë kanë qenë sugjerime tona, edhe unë gjithashtu po ju bashkohemi këtyre sugjerimeve, unë edhe heren e parë kur kemi pas diskutuar kemi thanë për këtë plan nëse nuk bahet kjo rruga mbrapa shtëpisë së kulturës dy kahe edhe ajo te lumi nuk bëhet dy kahe, ne zgjidhje do të bëmi vetëm ad-hok, pra do të jetë një zgjidhje e shkurt dhe mbas 3-4 vite prapë ka me u kërkuar nevoja. Më nxiti z.Dauti, kur tha se nuk kemi njerëz, na vërtetë nuk kemi njerëz, unë kur kam qenë student e kemi pas një profesor të ekonomisë dhe thoshte: “me këtë ekonomi, me këto resurse që i ka Kosova, vitin 2000 duhet të ketë 3.5 milion banor”, na jo vetëm që nuk i kemi këtë shifër, as në gjysmë të kësaj shifre. Unë falënderoj shumë profesorin e nderuar, unë e di se nuk është gabimi i tij, se atij ju ka dhënë një shabllon, kjo është rruga dhe këtu duhet me bë zgjidhje dhe as ky as unë e as supermeni nuk do të kishte me bë zgjidhje ma të mirë, por nëse i jepet dikujt një detyrë afatgjate, atëherë duhet me i pa se ku i kemi planet urbanistike, a janë në përputhje me dëshirat e tona, a ka nevojë diku për me ndërhy për me bë ndryshim, por problemi tjetër është se me atë trajtim që e kemi na edhe sot përmes këtyre planeve urbanistike dhe përmes lejjimit të ndërtimit në skaj të rrugës ne ja humbim perspektiven atij vendi, sepse me një të ardhme të shpejtë na nuk mund të bëjmë rrugë me dy korsi edhe faktikisht do të jetë si në kohën e osmanëve Vitia, pra me këtë perspektivë nuk do të ketë perspektiv për me pas një rrugë qysh duhet. Kështu që ma merr mendja që nuk është dashtë me u ngut nëse është investim i madh mos me harxhu pare në këtë punë, ma mirë presim edhe pak dhe ta bëjmë një plan ma të mirë që mos të harxhojmë pare kot.

**Kryesuesi:** Pasi nuk ka tjerë për të diskutuar, ja kisha dhanë fjalën profesorit.

**z.Mevlan Bixhaku:** Në radhë të parë të ju them të drejtën, ndoshta unë jam këtu i vetmi që nuk jam politikan, këtë qa po dua me ju thanë nuk e kam për ndonjë qëllim tjetër, mirëpo vetëm nga aspekti profesional, nëse mundem me konsiderua të tillë. Të gjitha vërejtjet çka u dhanë konsideroj se kanë qenë me vend nga aspekti profesional po flas. Meqenëse tu fillua prej asamblistit të parë, i cili i trajtoj shumë pika tjera, e deri te asamblistët e tjerë vetëm të ju tregoj se plani që ne kemi pasur në dispozicion për punë ka qenë plan i kufizuar në aspektin që ne nuk kemi mund me trajtuar ne secilin detaj, nuk kemi mund, p.sh.: secilin udhëkryq në aspektin e dinamikës së punës që kemi pasur dhe është kërkuar nga ne që ai plan të jetë sa ma i shkurt, që përmbajtja e tij të jetë sa ma pak, diku deri 40 faqe, e tash për me trajtua secilin problem natyrisht se ndoshta kërkon trajtim të veçantë, qa unë pajtona me ju se secili udhëkryq duhet të trajtohet nga aspekti i sigurisë, këto nuk do të thotë se nuk janë pjesë përbërëse e planit të mobilitetit. Plani i mobilitetit ndoshta ka pas si fokus kryesisht në pjesët e caktuara, të krijojë mundësi që të kenë qasje të gjithë pjesëmarrësit, natyrisht të lidh këtu edhe shkallen e sigurisë, ajo çka ndoshta u përmend te asamblistët që ndërlidhet me sheshin “Njazi Azemi” ishte devijimi i rrugës, respektivisht kyçja e rrugës “Adem Jashari” në rrugën “Kongresi i Manastirit”, nga aspekti teknik dhe funksional unë po e marrë guximin me thanë se

funksionon. Te parkingjet e njëtrajtshme që u përend nga asamblisti, që bëri pyetje, ekzistojnë disa lloj parkingje, mirëpo gjitha format e parkingjeve do ti përshtatin kushteve dhe rrethanave në pjesë të rrugës, ku duhet me u vendos zakonisht këto parkingje, ku janë të vendosura në rrugën "Adem Jashari", procedurën e kyçjes e kemi të letë, mirëpo shkyçja natyrisht kërkon edhe kritere të dukshmërisë edhe gjithmonë po mendoj shkalla e rrezikut është pak ma e madhe dhe ajo qëndron, mirëpo parkingjet gjatësore nëse vendosen paralel me aksin rrugor, atë si të tilla zakonisht janë ma jofunksionale për nga aspekti i parkingut, se kërkojnë ma tepër kohë. Mirëpo unë po lidhëm me atë se secila pjesë e rrugës, ku janë paraparë parkingjet, ju ka përshtat kushteve dhe rrethanave ku është e vendosur, te shërbimet taksi që janë vendos te pasqyra ne me grupin punues ndërlidhemi me aspektin funksional. Ju Vitin e njiheni shumë ma mirë, mirëpo në aspektin funksional, po flas që ky plan funksionon, p.sh. po lidhem në shtegun për çiklist, shtigjet për çiklist mund me qenë shtigje rekreative, kur e kryen orarin e punës dhe kam mundësi me dal me bë një qark me biçikletë, mirë por me i përmbush nevojat të lëvizjeve ditore, atëherë karakteri i atyre rrugëve nuk është ma atraktive po është nevojë e lëvizjeve ditore, edhe tash ndoshta pikërisht ka qenë problemi që apo ka qenë fokus që të krijohet një pjesë ku lëvizjet ditore kanë me qenë të lira. Tash ju përmendet shumë pika, pa dashtë me nda ndonjë pyetje, mirëpo në kuadër të këtij plani unë përmenda edhe në fillim që thash që fushë veprimi i planit ka qenë dashtë të jetë ma i gjerë. Unë u ndërlidha pak ma tepër te parkingjet edhe te devijimi i kësaj rrugës, se desha me shpjeguar se ajo formë funksionon edhe për nga kapaciteti edhe për nga niveli i shërbimit edhe për nga mundësia rrezeve adekuate, për pjesët tjera edhe unë pajtona që është dashtë të trajtohet, mirëpo nuk ka qenë fushë veprimi i këtij plani.

**z.Alban Sokoli:** Përsëritje për të gjithë! Unë do të jem shumë i shkurtër, ju kisha lutë që ta votoni këtë plan, për arsye se plani i ka kalua të gjitha fazat ligjore, të gjitha vërejtjet që u bërën këtu ka qenë dashtë të bëhen gjatë shqyrtimit publik dhe ne gjatë shqyrtimit publik nuk kemi pasur asnjë vërejtje, as nga qytetaret, as nga ju këshilltar, kështu që për fund edhe një herë ju kisha lutë që të votohet ky plan, për arsye se plani është i kalkuluar në mënyrë analitike, është analizuar mirë, është i bazuar në planet që janë të miratuara nga ky Kuvend.

**z.Sokol Haliti:** Të nderuar këshilltar, e nderuara zyra e OSBE-së, DEMOS-i dhe ju gjithë të pranishëm! Sot pata nderin që pata ambasadorin anglez në Viti, vërtetë ishte respekt për komunën tonë dhe nder që të jetë prezent, e pritëm në mënyrën ma të mirë, ishim gjithë bashkë, ndërsa sa i përket planit të mobilitetit unë nuk dëshiroj të flas, sepse dëshiroj ta respektoj fjalën e kuvendarëve, iniciativa ka qenë shumë e shëndetshme, shumë qëllim mirë, për shkak se neve na ka nevojit një plan i mobilitetit dhe falënderimi i takon DEMOS-it që na ka përkrahur në aspektin profesional, dhe ju takon anëtarëve profesional për hartimin e planit të mobilitetit, që vërtetë kanë punuar shumë në këtë kuptim. Kemi edhe një projekt tjetër me DEMOS-in, jemi kujdes që të jenë në harmoni dhe një pjesë e këtij plani me planin tjetër, të fillojnë vetëm mu zbatua, prandaj po ju përsërit edhe një herë, ju dëshiroj punë të mbarë në punët e Kuvendit dhe e përsërit edhe një herë DEMOS-in dhe anëtarët e komisionit që kanë punuar në këtë plan të mobilitetit.

**z.Daut Xhemajli:** U nxita prej asaj se u tha, që u kanë në diskutim publik e duhet me votua e tjera, por problemi është kështu, diskutime publike janë mendime të qytetarëve, të individëve të caktuar, këtu janë ata që duhet të vendosin dhe duhet me vendos dhe kanë obligim pavarësisht a kanë marrë në diskutime a nuk kanë marrë, kjo nuk ka rëndësi, ky ka dal, është propozuar si variant me ato vërejtje që kanë mund me u dhanë nga qytetaret, ka ardhur si version, na nëse dojmë me bë sheshin, dojmë me ja u lan njerëzve me u shëtitë, e caktojmë tabelën atje, që prej orës 18 deri në ora 22, se tërë ditën nuk është shëtitore, ky është

mendim i imi, por jam ka them se zgjidhja kështu si është propozua nuk është e mirë, tash a e votojmë a nuk e votojmë është tjetër send, unë jam kundër, zgjidhja tjetër duhet me u kanë.

**z.Sokol Haliti:** E përmendi ma herët asamblisti edhe urën te shkolla, dua ti them se ajo është duke u trajtua në një mënyrë të veçantë dhe ti Daut e dinë mirë problemin e urës, dhe është çështje e veçantë, nuk mendoj se është urë e shenjt.

**z.Bushat Zuka:** Në komunikacion është një rregullore se thotë, se përparësinë tënde kurrë mos e mendo si përparësi absolute, sepse kurgja nuk ka absolute dhe çdo vendim që po e marrim këtu nuk është absolut, që nuk mundemi me ndërrua nesra, pra, kemi mundësi me ndryshua, unë po ju lus prej këtu, sidomos Bekimin edhe Dautin, të bëni një grup punues dhe të hartojmë një rregullore për organizimin e komunikacionit në tërë territorin e Komunës së Vitisë.

**z.Bislim Bislimaj:** Unë nuk po mundem me ndikuar, po mundem me thënë, se Vitia ka pësuar aq shumë dhe si nuk u mësuam nga gabimet tona. Kjo shtëpi e kulturës 2-3 herë është rinovuar, e prishëm ëmbëltozen, tash duhet me pagua qindra mijëra euro. Unë po them ta thjeshtojmë këtë.

**znj.Ermira Salihu:** Të nderuar kuvendar, unë jam përfaqësuese e projektit DEMOS, punoj në fushën e shërbimeve komunale, më konkretisht jam përgjegjëse për fushën e mobilitetit, kemi punuar paralelisht në disa komuna, tash thuajse në gjitha komunat i kemi në fazën e miratimit nëpër Kuvende Komunale, thjesht këtu nuk dole për pjesën profesionale, se e sqaroi profesori, unë ma shumë po dua mu fokusuar në politikat e projektit që pak a shumë ne ja kemi imponuar komunave dhe grupit punues politik. E jona ka qenë me bë një plan të zbatueshëm, mos me bë plane milionëshe, se besoj se keni me dhjetëra të tilla nëpër sirtar të zyrtarëve komunal që asnjëherë nuk e kanë bë zbatimin, ky është plan i vogël dhe kjo sot çka pash unë është një nismë shumë e mirë. Plani u diskutua para jush në tërësi dhe ju tash jeni shumë të njoftuar me krejt objektivat e planit dhe qëllimin e planit në të ardhmen. Nuk po them që është plan perfekt dhe është shumë e vërtetë se nuk e ka mbuluar gjithë territorin e Komunës në tërësi, është fokusuar në zonën urbane. Thash, qasja e projektit ka qenë me hartuar një plan të zbatueshëm dhe po besoj se pak a shumë ja kemi dal, edhe se dikush tha do të jetë dështim, ndoshta, po plani në tërësi 5 vjeçar është vlera rreth 300 mijë euro, kur e ndan nëpër vite, është 60 mijë për një vit. Projekti DEMOS, në fondin e këtij viti dhe fondin e vitit tjetër e ka në vlerë 60 mijë euro, plus bashkëpunim me komunën thuajse po zbatohet gjysma e planit. Përparësi ju është dhënë mjeteve të pa motorizuara, unë po them se është nismë shumë e mirë, se së paku po diskutohet çështja e mobilitetit, që nuk është prek fare dhe unë vet si term para një viti apo dy viteve me punua në fushën e mobilitetit, kom than shpjegoma qa është mobiliteti. Krejt ato që u përmenden me u mbyll këto rrugë, tash plani i mobilitetit i trajton mobilitetin në infrastrukturën ekzistuese, dhe tjetra, se plani ka mundësin e rishikimit.

**Kryesuesi:** Ju faleminderit për diskutimet që u bënë për këtë pikë të rendit të ditës, në sall janë 24 këshilltar, e hedhi në votim për miratim. Me dhjetë vota pro, 4 kundër dhe 10 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi

## **2. Propozim vendim për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën ekonomike me statusin “Parku Industrial” në fshatin Budrigë e Epërme**

Ftoj drejtorin e drejtorisë përkatëse që ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Ajet Sallahu:** Me këtë propozim vendim, kërkojmë që të qasemi në hartimin e planit rregullues të hollësishëm, në të cilën do të përfshihen hapësirat e zonës industriale sipas

planit zhvillimor komunal, e cila ndodhet në zonën kadastrale në vendin e quajtur Batanica në fshatin Budrigë e Epërme, në pronësi të Komunës së Vitisë dhe duhet të jetë në përputhje me planin rregullues komunal dhe do të përfshihet në diskutim publik. Materialet i keni para vetes, për sqarime shtesë jam në dispozicionin tuaj.

**Kryesuesi:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush?

**z.Bislim Bislimaj:** Edhe një herë po e cekim, se sikur herën e parë që kemi diskutuar në lidhje me këtë plan, ne kemi thanë që kjo tok mos të shfrytëzohet, se kemi hapësira tjera që kanë vende ma atraktive dhe ajo tok pas pastrimit të “Moravës” është një ndër tokat ma të mira, dhe fatkeqësisht po kemi plani që po pamundësojnë zhvillimin e bujqësisë. Kjo zonë tregtare ndoshta edhe do të funksionoj, po në atë tokë mendimi im është, që nuk është dashtë me u bë.

**Kryesuesi:** Nëse nuk ka dikush tjetër, e hodhi në votim për miratim këtë pikë të rendit të ditës. Konstatohet se me votat e shumicës miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi

### **3. Propozim rregullor për qendrën rinore-Viti**

Ftoj përfaqësuesin e DKRS-së ta merr fjalën.

**z.Emrush Azemi:** Paraprakisht shfrytëzoj rastin që në emër të DKRS-së të falënderoj të gjithë ata që morën pjesë në aktivitetet e manifestimit “Flakadani i Karadakut”, meqë rast e begatuan me pjesëmarrje dhe angazhimin e drejtpërdrejtë në të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar brenda ditëve, prej 21 deri me 26 mars. Në vazhdim është draft rregullorja e propozuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, e cila rregullon organizimin e brendshëm të Qendrës Rinore në Viti, e cila është e rregulluar dhe e promovuar kohë më parë. Pasi kishte disa gabime në KPF, ne i kemi bërë përmirësimet e kësaj propozim rregullor dhe në Kuvend ka ardhur e përmirësuar. Materialin e keni marrë me kohë, për pyetje përgjigje jam në disponim të ju ndihmoj.

**Kryesuesi:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: Kush do ta merr fjalën?

**znj.Mirlinda Sadiku:** Këtu thuhet te Neni 6, pika c, “lokali i qendrës rinore menaxhohet nga Drejtoria Komonale e Rinisë dhe Sportit, respektivisht nga koordinatori i qendrës së rinisë”. A do të thotë kjo se do të merret ndonjë punëtor i ri, apo do të angazhohet dikush nga DKRS-ja që të menaxhoj me këtë qendër?.

**z.Bislim Bislimaj:** Këtu do të kisha shprehë falënderim që është tu bë ky draft, sepse e di se më duket ky është drafti i parë që i kushtohet rinisë, sportit dhe kulturës në Viti.

**z.Emrush Azemi:** Koordinatorin zgjidhet nga grupet rinore, d.m.th ato të brendshme, ne nuk do të përziemi në çështjet e brendshme, është këshilli i veprimit rinor lokal që është ombrell e të gjitha organizatave rinore, kështu që, me pëlqimin e tyre në përgjithësi përcaktohet edhe koordinatori i brendshëm, duke pasur parasysh se gjithmonë drejtoria, konkretisht përgjegjësi për rini është ai i cili do të menaxhoj me asetet e brendshme të qendrës rinore. Sa i përket organizatave tjera, absolutisht janë të lirë secili, pikërisht është ai koordinatori i brendshëm që e bën organizimin e brendshëm dhe koordinimin e aktiviteteve. Dhe kjo nuk e parasheh me u marrë një punëtor i ri, po zgjidhet nga organizatat rinore të cilat janë themeluese të këtij këshilli.



**Kryesuesi: E** hedhim në votim që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës, konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi:

#### **4. Propozim rregullore për vendosjen,ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike**

Është një rregullore që e kemi miratuar në një prej seancave të kaluara, por na e ka kthyer MAPL që të përimitohet në preambulën e saj. I japim fjalën drejtorit të drejtorisë përkatëse.

**z.Ajet Sallahu:** MAPL na e ka kthyer me një vërejtje shumë të vogël në preambulën e saj, që ka qenë më herët, në bazë të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja c, e tash thotë të shkruhet në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja c.

**Kryesuesi:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

**z.Sejdi Emini:** Kjo rregullore ka qenë edhe ma herët dhe ne mbajmë të njëjtin qëndrim, se një rregullore e tillë nuk mendojmë që ka me larguar objekte, siç janë kioskat në Viti e Pozheran, por vetëm sa kanë me u vendos edhe të tjera, prandaj kishmi lut me qenë shumë konstruktiv që mos ti shumtojmë as Pozheranin e as Vitinë me këto kioska, sepse unë mendoj se qëllimi është që të vendosen e jo të heqen. Mbetet të shihet, por prapë e përsërisë, se duhet me qenë të kujdesshëm që mos me u vendos, se edhe këto që janë nuk po i japin pamje të mirë vendit.

**Kryesuesi:** Pasi nuk ka tjerë për të diskutuar: Kush është që të miratohet kjo rregullore? Konstatoj se me shumicë votash u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi:

#### **5. Propozim vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2015 në vitin 2016**

Ja kisha dhanë fjalën drejtorit rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Ibrahim Rama:** Është fjala për vlerën 141 mijë 642 euro mjete nga të hyrat vetanake në vitin 2015 dhe që nuk janë shpenzuar këtë vit, dhe në bazë të ligjeve duhet të barten në vitin 2016 dhe të inkorporohen në buxhetin komunal për këtë vit, materialin e keni marrë me kohë kush ka dikush të pa kuart jam në dispozicion ti ndihmoj.

**Kryesuesi:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?, nëse nuk ka, atëherë po e hudhi në votim që të shkoj për miratim edhe kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se me shumicë votash aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Dhe natyrisht me pëlqimin e juaj pyetjet dhe propozimet i lamë për fund të të seancës. Siç e dini Bekimi vazhdimisht ka parashtruar një kërkesë, që ti sjellet lista e subvencioneve, mua sa mu informua, nënkryetari një listë të tillë ja ka dëruar Bekimit, po sido qoftë unë po e hapi debatin nëse ka ndokush ndonjë pyetje ndonjë propozim, fjala është për ju.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Kisha mi ngrit disa çështje, e para është në pasqyrat e fundit financiare, shuma e cila është shpenzua nga Zyra e Kryetarit, faktikisht për udhëtime zyrtare jashtë vendit është 5100 euro, do të kisha dashtë që në një tërësi ndër seancat të kemi një raport ma të detajuar, se cilat janë vendet që i ka vizituar kryetari, cilat janë të mirat që i ka sjell

komunës me këto vizita. Çështja e dytë, i kisha bërë pyetje Drejtorisë së Shërbimeve Publike, me sa e di unë Fardin Islami nga fsh Lubishtë rrezikohet nga rrëshqitja e dheut, disa herë ka kërkuar ndihmë dhe më ka ratisë që dy fëmijët e tij të mësojnë në shkollën tonë dhe i kam pyet për gjendjen, se nuk kam mund me vizituar atë lokalitet, më kanë thënë se është në gjendje të keqe, megjithatë do të kisha dash ta kem një vlerësim qoftë nga ju qoftë nga njerëzit profesional, se a paraqet rrezik për këta njerëz që jetojnë në ato shtëpi. Çështja tjetër, po ashtu ka të bëjë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në pjesën e epërme të fshatit Skifteraj, më konkretisht te rruga “17 Shkurti” në lagjet Kamberi, Shabani, Hajdari, Bislimi, Rashiti, Islami, Sulejmani, Ismajli dhe Rexhepi është premtuar që një vit trafo elektrike, ekziston edhe kërkesa e deponuar nga fshataret, por ende nuk ka veprim konkret në këtë drejtim dhe rryma është mjaft e dobët, ndërsa çështja fundit, ekziston një raport i publikuar në [www.kallxo.com](http://www.kallxo.com), i publikuar me 13 dhjetor 2015, ndoshta drejtori i Financave ka mundësi të na jep ndonjë sqarim, ku thotë se Vitia nënshkroi kontrata me 2 milion 616 mijë euro, shpenzimi me shumë parave për kontrata që komuna e Vitisë i ka nënshkruar për kryerjen e punëve të ndryshme është bërë e ditur nga raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2014, që është publikuar në portalin zyrtar të dhënave të hapura, në këtë raport thuhet se Komuna e Vitisë disa kontrata i ka nënshkruar shumë herë më të larta se sa vlera e parashikuar për to tejkalime kontratash kanë bërë, po i lexoj vetëm disa prej tyre; rruga Pozheran –Sllatinë 120 mijë euro dhe çmimi 146 mijë e 717 euro, kanalizimi Germovë 80 mijë, çmimi 106 mijë e 729 euro, kanalizimi Gushicë 70 mijë, çmimi 78 mijë 274 euro janë vetëm disa prej shifrave ku tejkalimi i shumës së kontratave gjatë vitit 2014 është 199 mijë e 43 centë, prandaj sipas komisionit rregullativ të prokurimit publik tregon se për çfarë arsye mund të tejkalohen shumat e planifikuara të kontratave i citoj fjalët e tyre. Në rast se kontratat jepen me çmime më atë larta se sa vlera e parashikuara të këtyre aktiviteteve të prokurimit, në të shumtën e rasteve ndodhin për arsye të mosvlerësimit në rregull të çmimeve të tregut nga autoriteti kontraktues, megjithatë KRPP-ja thotë se në përgjigje bënë me dije se çmimi kontratës rritet shumë herë, atëherë autoritetet kontraktuese mund ta anulojnë atë në bazë të ligjit nr.04 / L- 042 për prokurimin publik, në dispozitat me nenin 62, paragrafi 1 pika 2, ku i lejon autoritetit kontraktues që të anuloj një aktivitet të prokurimit nëqoftse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime, që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues.

**z.Sejdi Emiri:** Po ndalem te Mirlinda, te kanalizimi për Gushicë, është shumë e vërtetë ma herët ka qenë 70 mijë, tani u bë 78 mijë euro, mirëpo personalisht unë me këshillin e fshatit kemi shkua dhe kemi kërkuar se ka pas mangu, ka mbet, nuk i ka plotësua kushtet për një 1 km dhe atë hapësirën 10% e kanë shfrytëzua dhe është rritur kosto për sa e di unë. Sot do të ndalem te 3-4 pika edhe unë së pari po ndalem. Kryesues, kemi kërkuar një zyre si **VETVENDOSJE** nuk keni gjetur hapësirë apo nuk keni pas vullnet, kjo mbetet çështje e juaj, mirëpo, sidoqoftë na qëndrojmë prapa kërkesës sonë, se mendojmë se na takon edhe neve qysh i kanë të gjitha subjektet e tjera politike. Tjetra, do të ndalem te arsimit drejtor, e di se data 15 prilli është afati kohor kur nuk jemi të obliguar ti dhezim zjarret nëpër shkolla, edhe përkundër shëndetësisë se e kanë bërë një plan të mobilitetit gjoja se për gripe, është e kot

sepse nëpër shkolla edhe sot nuk ka zjarre, sepse nuk ka derivate për djegie. Shumë shkolla janë detyruar ta reduktojnë kohën, mos të jenë orët 40 minuta, por të bëhen 30 minuta dhe këto që po i them i kam me fakte, prandaj një muaj para kohe ti lëmë nxënësar pa zjarre besoj se kjo nuk është mirë. Tjetra, po ndalem te tregu i kafshëve, edhe pse e kemi caktuar vendin, ndoshta edhe dy vite nuk do të dalim atje ku e kemi caktuar vendin, sa ma herët që ta bëni këtë zgjidhje është ma mirë, se është pengesë tash ku është tregu. Tjetra, te Bujqësia, edhe se po flitet shumë për bujqësi, unë po mendoj se pak po bëhet, ne kemi shumë kërkesa prej fshatrave që rrugët bujqësore të rregullohen, andaj ne e kemi obligim së paku atë rrugë ta bëjmë të kalueshme.

**z.Bekim Azizi:** Faleminderit për shënimet që mi keni sjell, nuk janë të plota, janë 69 mijë euro, i kam lyp 13 seanca rend, janë mbi 100 mijë euro subvencione, që janë kanë 35 mijë euro, që janë kanë për bursa të studentëve, ato nuk ju kanë dhanë në vitin 2014, ato nuk figurojnë, d.m.th janë të mangta, por për 69 mijë euro mi kanë sjell, bash ato që i kanë kërkuar nuk mi kanë sjell, sot isha kyç kështu në qendër të qytetit, 100 metra prej komune është një ndërtim tu bë tash, është prish posta vjetër, pronësia e kujt është, e kujt është toka, ndërtimi është prish, a u marr leje prej komune, brenda jave objekti është bërë 2 kate, objekti është duke u ndërtuar pa leje, plani i objektit është bërë nga punëtori i administratës komunale, ndërtimin është duke e bërë një i afërm i kryetarit, problemi është shumë serioz, kisha ftuar prokurorin që këtë rast ta shqyrtoj shumë seriozisht, sepse këtu ka shkelje shumë të mëdha te objekti te posta e vjetër që është duke u ndërtuar. Ambullanta e Pozheranbnit, na e dimë që është lëshuar që një muaj, gati një metër është myk rreth e rreth, nuk e di ai punëkryerësi a i ka marrë krejt paret a qa janë tu bë aty, mirëpo është gjendje shqetësuese, sepse është myk një metër pjesa e murit prej tokës, d.m.th kjo tregon se nuk janë kryer mirë punimet, janë marrë diku 8 veta me punu, a ndoshta numri është edhe ma i madh kishe përmes KARITAS-it, po i shtini me punua pa asnjë konkurs, nuk e di çka është duke u mbuluar aty, nëse KARITAS-it po i merr ku po i merr krejt të tyre që janë bash të LDD-së që po thotë Ekremi, dy punëtorë te zyra e adresave pa kontrata që një kohë punojnë, tash për momentin as nuk kanë kontratë, as nuk e dinë si punojnë, as nuk dinë si ju del paga, nuk dinë qa janë tu bë edhe ata besoj se një zgjidhje e tyre duhet me u bë.

**z.Baki Nebihu:** Para se me diskutua në lidhje me tjera gjëra, kisha pasur dëshirë me përshëndetë drejtorin e ri dhe i uroj punë të mbarë në detyrën që e ushtron tash edhe se sot zyrtarisht është dashtë të na jepet një njoftim nga kryesuesi, por kjo nuk ndodhi: Unë këtu po dua me i cek disa shqetësime të qytetarëve, të cilat kanë ndodh me vërshimet e fundit në Komunën e Vitisë, e po ndalem në dy lagje të Vitisë, të cilat gjatë vërshimeve kanë sjell dëme mjaft të konsiderueshme të banorëve të asaj lagje, njëra prej këtyre lagjeve është rruga “Dëshmoret e Kombit” dhe si pasoj e kanalizimit i cili vjen nga Kabashi dhe ka gjerësinë e gypave me fije 600 dhe ku lidhte m gypat e Vitisë dhe ata gypa janë me fije 400, aty bëhet apo bllokohet për shkak shirave të mëdha, bllokohet kanalizimi dhe vërshohen ato lagje. Problemi i këtyre lagjeve është se problemi po dihet dhe nuk po intervenohet, andaj këta banor të këtyre lagjeve kërkojnë me ditë nga komuna a do të intervenohet në këtë vit në ato pjesë ku po dihet, ku po qëndron problemi te kanalizimi. Njëjtë është edhe te rruga “Hasan Kabashi”, ku

fillon rruga e Kabashit, problemi kryesor është prrocka e cila vjen në malet e Kabashit, ajo prrock ngritët nga uji vetëm kur ka shira dhe vërshohet. Problemi është dhe besoj se edhe kryetari e dinë, devijimi i asaj prrocke, edhe këtë banoret kërkojnë, pse nuk intervenohet kur problemi dihet dhe a do të intervenohet në këtë vit. Edhe një shqetësim tjetër e kam, të një qytetari të Komunës së Vitisë, drejtori i Shëndetësisë nuk qenka, ky qytetar i bënë pyetje drejtorit të Shëndetësisë, që deri kur në shtëpinë e shëndetit në Viti nuk do të ketë gaza sterile rregullisht në qendren e emergjencës si dhe pse nuk ka sterilizator, kur e dimë se aksidentet ndodhin në kohë të ndryshme e jo vetëm prej orës 8 deri ora 15. Unë i kërkoj drejtorit që me bë përpjekje ma të mëdha te kryetari, që së paku nevoja elementare që të jenë gjithmonë prezentë në këtë qendër.

**z.Bislim Bislimaj:** Edhe unë për të satën po e i përsërisë, ato shqetësimet e mia në lidhje me planet zhvillimore të Komunës së Vitisë ne në këtë Kuvend kam menduar se do të ndikojmë edhe ne pak si opozitë, por edhe tjerët koleg tanët që janë në pozitë për me zhvilluar atë qa mundin me zhvilluar në Komunën e Vitisë edhe nëpër seanca të Kuvendit shumë pak kemi pasur mundësi edhe rast me pa aso plane apo aso projekte edhe për me aprovua na ma tepër ose aprovojmë projekte për bujqësi ato që i kemi gjithmonë prioritet, që duhet me i bë prioritet dhe këto me të vërtetë më shqetësojnë, unë kam prit se ndoshta ndonjë pik të rendit të ditës kur kemi ma pak ngarkesë të kemi, p.sh.: për me shtrua ndonjë rrugë ndërrbane, sikur që është rruga e Vitisë me Sllatinë ose rruga e Vitisë me nga Stublla për me u lidh me rrugën e Stanqiqit ose rrugën e Debelldehut, që duhet me u lidh me Shkup, do të thotë me i zhvillua disa rrugë që ne si komunë kemi obligim me ja mundësua njerëzve një tregti legale, thjesht jam i shqetësuar pse nuk po mundemi me i zhvilluar edhe ato biznes që janë pak a shumë si restorante, p.sh.: si Korbliq, Kabash e vende tjera, ku e dimë se ne nuk kemi ku ta kalojmë kohën e lirë në vikend. Një shqetësim tjetër, jam pjesëtarë i komitetit për komunitete, aty vazhdimisht kur i mbajmë ato seanca të rralla me të vërtetë po i merremi disa vendime, por ato asnjëherë nuk po i zbatojmë. Aty përfshihen jo vetëm komunitetet, por edhe mazhoranca. E kemi shprehur se disa banorë që jetojnë në Letnicë janë në gjendje të rëndë financiare dhe e kemi obligim moral të ju ndihmojmë.

**znj. Xhilsime Qamili:** Unë shkurtimisht me kolegun këshilltar nuk do të kundërshtohem në asnjë formë, por vetëm dua ti sqaroj që në të gjitha vendet ku bëhet aplikimi dhe ku bëhen lidhjet, sterilizator ka bie fjala në QKMF ka sterilizator dhe ku aplikohen ineksionet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, po ashtu ka sterilizator dhe në emergjencë, ku tash funksionon, ekziston sterilizatori gjithsesi dhe funksionon shumë mirë. Çka është me rëndësi ne e kemi një lidhtore të veçantë, punëtorja që punon aty është edhe e trajnuar për shkëputjen diabetike, bën lidhje tërë kohën që nga ora 8 e deri në 15 është funksionale, i ka të gjitha mjetet e sterilizuara prej fashove, gazrave, mjeteve sterile është shumë mirë e pajisur, por nuk na mungon edhe puna që e bëjmë edhe me këtë formë sterilizuese, si bie fjala me një dubosh (kaseta për gazra sterile), që e kemi të përgatitur shumë në formë komode dhe motra del në terren dhe bën pastrimin e plagëve të pacienteve që nuk mund ti qasen Qendrës së Mjekësisë Familjare apo Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Dua të përgjigjem edhe nga ajo që pacientët që janë në Letnicë edhe ata vizitohen nga punëtorët tanë si nga stafi

infirmierik, ashtu edhe nga stafi profesional mjekësor, kështu që dy herë në javë e kanë mjekun aty, kurse stafi infiermerik është i rregullt, që iu ofron ndihmë mjekësore atyre rasteve edhe atyre pleqve, por nuk mungojnë edhe vizita sistematike që iu bëhet nga ekipi i CARITAS-it, që është vazhdimisht në terren.

**z.Baki Nebiu:** Unë vetëm desha ta cek se ato që iu thash unë është prej një pacienti nga Komuna e Vitisë, unë nuk e thash që më ka ndodhur mua, por edhe përgjithësi dihet që në Komunë të Vitisë pas orës 15 mungojnë pajisjet.

**Kryesuesi:** Shfrytëzoj rastin të iu uroj suksese drejtorit të ri të Drejtorisë së Gjeodezisë, që është emëruar nga kryetari për periudhën 6 mujore, sepse drejtoresha është në pushim të lehonisë. Dhe pyetja që mu drejtua si kryesues i Kuvendit Komunal lidhur me kërkesën që ta hapim zyrën e tyre. Unë e kam marr një kërkesë të tillë dhe dëshira është që të kemi të gjitha subjektet politike, por kemi mungesë të lokaleve, është pak problematike, por nuk është obligim i komunës të iu siguroj zyre partive politike, por vullneti ekziston.

**z.Hasan Aliu:** Çështjet që u ngritën nga këshilltarët, i kemi këtu drejtorët dhe mund të përgjigjen drejtorit konkretisht. Sa i përket pyetjes së Mirlindës, më vjen keq, por ti më shumë e ke bërë një lexim, unë besoj se ajo ka qenë një periudhë që ka kaluar dhe nëse kthehem në ato besoj se na del shumë punë dhe më tepër ka qenë një citim, por të gjitha vërejtjet që i ngrisin ne duhet ti përmirësojmë. Sa i përket udhëtimeve zyrtare të kryetarit, është dokumentacioni dhe dokumentet përcjellëse dhe ju mund të bëni kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Çështja e energjisë së atyre lagjeve dhe mesin e tyre kemi bërë lëvizje në fshatin Skifteraj për të mirë dhe gradualisht i vije rendi edhe atje, mirëpo ju duhet ta keni parasysh që KEDS-i është një kompani private dhe ju falënderojmë edhe juve për bashkëpunimin. Te tregu i kafshëve, është shtyrë sepse “Eco Higjiëna” është kompani privatopublike dhe ndoshta aduti tjetër është se mos po mundemi ta thithim si donacioni nga partneriteti që e kemi publiko-private dhe vonesa e palestrës është një pengesë edhe për komutacionin. Së pari duhet ta pranojmë një gabim që është vendosur aty, por do të përmirësohet. Baki, prita që kësaj radhe do të na lavdëroni, sepse më së paku vërshime kemi pasur në nivel të Kosovës, për shkak të aktiviteteve si kryetar i komunës. Çështja e Shtëpisë së Shëndetit, unë e shpjegoj atë mykin nuk e di dhe atë ditë që është prerë shiriti nuk kam qenë këtu, por megjithatë nuk mundem të them a është apo nuk është, por me parë është shumë funksionale, si shqetësim mirë që e ke paraqitur dhe do të shikohet konform garancionit të përmirësohet ajo. E more edhe nga drejtoresha përgjigjen, se është intervenuar dhe ne e dimë që është gjendja e rëndë, por herë pas here janë ndihmuar ata dhe është ndihmuar edhe kuzhina popullore ku ushqehen ata. Kemi bërë përpjekje aq sa kemi mundësi.

**z.Ibrahim Rama:** Sa i përket pyetjeve të Mirlindës, sa i përket shpenzimeve zyrtare jashtë vendit të kryetarit të komunës është transparente, dokumenti është valid dhe me kërkesën e juaj mund tua sjellim dhe pyetja e dytë që më bëri përshtypje është fjala për nënshkrimin e kontratave, kështu vlerën për vitin 2014 nuk i kam për momentin dhe asnjë kontratë nuk është nënshkruar pa mbulesë financiare dhe nuk kemi borxhe ndaj asnjë kompanie dhe të gjitha projektet i kemi ndihmuar edhe me ridestininim të mjeteve dhe me të hyrat vetanake.

Pyetja tjetër ishte për marrëveshjen që e kemi me CARITAS-in për punësimin e punëtorëve për shërbime të veçanta, ne e kemi marrëveshjen e nënshkruar nga CARITAS, MAPL dhe Komuna e Vitisë dhe ne jemi vetëm shfrytëzues të këtyre shërbimeve nga marrëveshja që e kemi me CARITAS-in dhe e kemi problemin me kanalizimin në disa lagje të Komunës së Vitisë dhe jemi duke bërë përpjekje dhe besoj që këtë vit do të rregullohet, sepse është problemi i një gypi të kanalizimit dhe jemi duke u munduar ta zgjidhim.

**z.Qahil Sinani:** Të gjitha shkollat që janë në Komunën e Vitisë, lëndë djegëse kanë pasur mjaft, kuptohet te shkollat që janë me nxemje qendrore është me mirë, sepse aty mund të intervenohet aty për aty dhe te shkollat që janë me kaftor vërtetë që është problem, sepse edhe drunj shpenzohen edhe më tepër.

**z.Nexhmedin Jakupi:** Gjatë vitit kaluar, gjatë stinës së pranverës, kemi pasur shembje të dheut dhe atë në dy lokalitete, në një lagje që quhet “Lagjia e Shaqirëve”, fshati Debelldeh, mirëpo Komuna e Vitisë ka pasur mundësi dhe kapacitete për ta zgjidhur këtë problem, ndoshta jo të përhershëm, por ka mundur të intervenoj, por rasti i Lubishtës është një problem i rëndë, ngase ky problem i tejkalon mundësitë dhe kapacitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Ne që në start jemi marr me këtë problem dhe i kemi marr të gjitha hapat e nevojshëm, vazhdimisht e kemi përcjell gjendjen atje, por si komunë nuk kemi buxhet për raste të tilla dhe vazhdimisht iu kemi drejtuar nivelit qendror për ndihmë financiare dhe përgatitjen e ndonjë projekti.

**Kryesuesi:** Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë.

Mirë u pafshim!

**Mbledhja përfundoi me punë në ora 12 e 30 min.**

**Procesmbajtës :**  
**Ilir Zuka**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal-Viti**  
**z.Naim Pira**

-----

-----